



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR**

Nr. 343 / Prot./D.P.

Tiranë, më 13.04.2021

Lënda: Përcillet për kompetencë materialit kallëzues.

Drejtuar: PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TIRANË

Për dijëni: PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË

TIRANË

Me shkresën nr.66 prot, datë 15.04.2021, është depozituar kallëzimi penal nga subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. G.Bardhi, ku nga ana e kallëzuesit është pretenduar kryerja e veprave penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, parashikuara nga nenet 248, 328, 328/a të Kodit Penal.

Pas studimit të hollësishëm të kallëzimit, rezulton se nuk ka të dhëna për veprën penale të “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, apo për ndonjë vepër penale tjetër të kryer nga subjekti i posaçëm në zbatim të nenit 75/a të K.Pr.Penale.

Nga kallëzimi pretendohet edhe për veprime të Administratorit të Njësisë Administrative nr.9, Bashkia Tiranë, *me qëllim ndikimin në fushatën zgjedhore dhe ndryshimin e rezultateve zgjedhore, duke përdorur asete dhe burime njerëzore të administratës shtetërore*, veprime këto që mund të kualifikohen në kuadër të veprave penale të tjera, atë të “Shpërdorimit të detyrës”, “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, parashikuara nga nenet 248 dhe 328/a të Kodit Penal.

Në këto rrethana, pavarësisht pretendimit të kallëzuesit për veprat penale të kryera dhe subjektet e përfshirë, konstatohet që materiali përmban indicie që referojnë për vepra penale që nuk janë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, apo subjekte të posaçëm, referuar nenit 3 të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Për këtë arsye, ju përcjellim materialin kallëzues për vlerësim nga ana juaj. Nëse në vijim konstatohet ndonjë element i veprës penale apo subjekt në kompetencë hetimi sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, të dërgohen aktet në Prokurorinë e Posaçme.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

Arben KRAJA

